


01-2727



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-266596/21 dt. 08.12.2021, të pronarit Driton (Afrim) Pustina nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën e banimit individual, ndërtuar në rrugën “7 Marsi”, në Lagjen “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 10.06.2022, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET Driton (Afrim) Pustina nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-266596/21 dt. 08.12.2021, përdorimi i ndërtesës, shtëpi banimi individual me etazhitet B+P+1ET, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-159459 dt. 25.09.2014, në kuadër të bllokut urban “L-47” të tërësisë “L” të Planit rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 255-4, Zona Kadastrale Çagllavicë, në Prishtinë,

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “7 Marsi”, numër 24, në Lagjen “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronari Driton (Afrim) Pustina nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-266596/21 dt. 08.12.2021, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shtëpi banimi individual me etazhitet B+P+1ET, të ndërtuar në rrugën “7 Marsi”, numër 24, në Lagjen “Prishtina e Re-zona perëndim”, në Prishtinë, konkretisht në parcelën kadastrale nr. 00255-4, Zona Kadastrale Çagllavicë, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-159459 dt. 25.09.2014, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-108375/21 dt. 30.07.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Njoftimin mbi Inspektimin Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga Inspektori i Ndërtimit i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesi kan prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të

punëve të arkitekturës; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit; Incizimin gjeodezik të objektit, nga gjeodeti i licencuar për matje gjeodezike Xhavit Fetahu me nr. të licensës 75; Vendimin nr. 05 Nr. 351-159459 dt. 25.09.2014 për lejimin e ndërtimit të shtëpisë individuale të banimit në kuadër të në kuadër të bllokut urban "L-47" të tërësisë "L" të Planit rregullues "Prishtina e Re-zona perëndim", konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale me numër 00255-4, Zona Kadastrale Çagllavicë, në Lagjen "Qëndresa" në Prishtinë. Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit: Riad Kryeziu, IDN. udhëheqës i vend ndërtimit, Blerta Spahija, IDA. mbikëqyrës për arkitekturë, Arsim Rapuca, IND. mbikëqyrës për Strukturë, Naim Munishi, IDH. mbikëqyrës për Hidro-Instalime, Berat Hasanaj, IDE. Mbikëqyrës për Instalime elektrike, Gazmend Krasniqi, IDM. Mbikëqyrës për Instalime Makinerike dhe matjet Gjeodezike nga gjeodeti i licencuar për matje gjeodezike Xhavit Fetahu me nr. të licensës 75.

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, Raportit të Komisionit të Inspektimit Final të Inspektionit, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, ka konstatuar se: Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, dhe punëve zeytare si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen ndërtimore 05 Nr. 351-159459 dt. 25.09.2014. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shtëpi banimi individual, mund të përdoret.

Në Raportin e Inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektori i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në objekt janë të përfunduara. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë të aprovuara nga ana e Inspektionit të Ndërtimit.

Kërkesat e Vendimit Lejes Ndërtimore janë zbatuar,

Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave,

Masat për kursim të energjisë janë zbatuar.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shtëpi banimi mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shtëpi banimi individual.


Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.


Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuarit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspektionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-266596/21 DT. 10.06.2022**

Zyrtari,
Berim Osmanaj



U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



Drejtori,
Arber Sadiki

